



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.124**

**9 shtator**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.655, datë 28.7.2010	Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës..... 6585
Vendim i KM nr.656, datë 28.7.2010	Për përcaktimin e detyrave, përgjegjësi të bordit të qiradhënies, procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore të pakultivuara dhe kontratës tip të qiradhënies së tyre..... 6590
Vendim i KM nr.663, datë 4.8.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.584, datë 27.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për dhënie ndihme financiare familjeve të viktimave dhe të të mbijetuarve të aksidentit rrugor, të datës 17.7.2010, në aksin Rrëshen-Fushë-Arrëz..... 6595
Vendim i KM nr.666, datë 4.8.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.314, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe për përcaktimin e shpërbllimit të personave të tretë në administrimin e pasurisë”..... 6596
Vendim i KM nr.667, datë 4.8.2010	Për emërimin në detyrë të tre anëtarëve të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura..... 6597
Vendim i KM nr.668, datë 4.8.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2010, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, për realizimin e veprimtarive kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezës..... 6598

Vendim i KM nr.669, datë 4.8.2010	Për lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si autoritet kontraktor, për të kryer procedurat e prokurimit për objektet “Investim për skemën e ullirit, sera prodhim fidanësh” dhe “Thellim i shtratit të lumit Devoll (ura e Maliqit), Korçë”, dhe për të lidhur kontratat përkatëse.....	6598
Vendim i KM nr.671, datë 13.8.2010	Për dhënie ndihme financiare Qeverisë së Republikës së Moldavisë dhe Qeverisë së Republikës Islamike të Pakistanit, për lehtësimin e pasojave, të shkaktuara nga përmbytjet.....	6599
Vendim i KKRT nr.37, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Ngjallja”.....	6600
Vendim i KKRT nr.45, datë 28.7.2010	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio X”.....	6600
Vendim i KKRT nr.46, datë 28.7.2010	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio 6”.....	6602
Vendim i KKRT nr.47, datë 28.7.2010	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “AVN”.....	6603
Vendim i KKRT nr.48, datë 28.7.2010	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Dibra Vizion”.....	6605
Vendim i KKRT nr.54, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për radion vendore private “Greta Music Radio”.....	6606
Vendim i KKRT nr.55, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio One”.....	6607
Vendim i KKRT nr.56, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio One”.....	6607
Vendim i KKRT nr.57, datë 28.7.2010	Për zgjerim zone licencimi për radion vendore private “Radio Energy”.....	6608
Vendim i KKRT nr.58, datë 28.7.2010	Për moszgjerim zone licencimi për radion vendore private “Love Radio”.....	6608
Vendim i KKRT nr.59, datë 28.7.2010	Për moszgjerim zone licencimi për radion vendore private “Radio DJ 96.1”.....	6609
Vendim i KKRT nr.60, datë 28.7.2010	Për moszgjerim zone licencimi për radion vendore private “Radio B-94”.....	6610
Vendim i KKRT nr.61, datë 28.7.2010	Për mosdhënie licence për radion vendore private “Radio Blu”.....	6610

Vendim i KKRT nr.62, datë 28.7.2010	Për mosdhënie licence për radion vendore private “Radio Apollon” .....	6611
Vendim i KKRT nr.63, datë 28.7.2010	Për mosdhënie licence për radion vendore private “City Star Radio” .....	6612
Vendim i ERE nr.52, datë 9.8.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k.....	6612

**VENDIM**  
**Nr.655, datë 28.7.2010**

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E NDRYSHIMIT TË KATEGORIVE TË RESURSEVE TË TOKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1 të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. PËRKUFIZIME**

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Kalimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera dhe anasjelltas”, veprimet procedurale e dokumentare dhe miratimet që bëhen nga strukturat shtetërore, të përcaktuara në këtë vendim, që sjellin për pasojë kalimin e tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera, apo kalimin e kategorive të resurseve të tjera në tokë bujqësore. Ky kalim pasqyrohet në dokumentacionin kadastral shtetëror.

2. “Subjekte të interesuara për kalimin e kategorive të resurseve”:

a) personat fizikë apo juridikë të cilët e kanë në pronësi private tokën bujqësore, tokën pyjore, pyllin, kullotën, livadhin, tokën e pafrytshme dhe që shprehin interes apo kërkojnë kalimin nga një kategori resursi në një kategori tjetër;

b) organet e qeverisjes vendore apo institucione të tjera shtetërore që, bazuar në akte ligjore ose nënligjore, kanë në administrim/përdorim apo në pronësi tokën bujqësore, tokën pyjore, kullotën, livadhin, tokën e pafrytshme, sipërfaqe të brigjeve të lumenjve, sipërfaqe këto në pronësi shtetërore (publike) dhe që shprehin interes apo kërkojnë kalimin e një kategorie resursi në një kategori tjetër.

3. “Subjekte të interesuara për ndryshim të tokës bujqësore në tokë urbane (truall), në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore dhe karriera”:

a) personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë kërkesën pranë ministrive përkatëse që mbulojnë këto veprimtari;

b) ministrinë përkatëse, si dhe autoritetet e planifikimit, që kanë kompetencë dhe përgjegjësi për planifikimin e territorit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. “Subjekte të interesuara për kalimin e tokave bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit, për ushtrim të veprimtarive të domosdoshme”, ministrinë përkatëse që mbulojnë veprimtarinë për të cilën kërkohet kalimi i tokës.

**II. KALIMI I TOKËS BUJQËSORE NË KATEGORI TË RESURSEVE PYLL, TOKË PYJORE, KULLOTË DHE LIVADH**

1. Tokat bujqësore të kategorive nga I deri në IV nuk lejohet të kalojnë në kategori të resurseve pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh.

2. Subjekti i interesuar, pronar privat, për kalimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore, toka të cilat nuk përfshihen në pikën 1 të këtij kreu, në kategori të resurseve pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, paraqet kërkesë në komunë dhe/ose bashki, në juridiksion të së cilës ndodhet toka, për kalimin e saj në kategori të resurseve pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh.

Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban:

- identitetin e kërkuesit;

- përshkrimin e veprimtarisë që do të ushtrojë në sipërfaqen e kërkuar për kalim dhe efektet ekonomiko-financiare të këtij kalimi;

- miratimin, në parim, nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor e juridiksionit përkatës, për veprimtarinë që do të kryhet në këtë sipërfaqe, pas kalimit të saj;

- fotokopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë mbi tokën;
- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet kalimi, me kufijtë e saj qartësisht të dallueshëm, në shkallën 1:2500 ose 1:5000;
- mendimin e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DRBUMK) për kalimin e kërkuar;
- vërtetimin origjinal të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), e qarkut, për kategorinë e tokës sipas bonitetit.

3. Këshilli i komunës dhe/ose bashkisë e shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të saj.

Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) në komunë dhe/ose bashki përgatit paraprakisht një raport teknik, që miratohet nga kryetari, për përmbajtjen e kërkesës dhe, në përshtatje me politikat e planifikimit vendor të territorit të komunës, shprehet për miratim ose jo të kërkesës. Kërkesa e miratuar paraprakisht, bashkë me vendimin e këshillit të komunës dhe /ose bashkisë, i dërgohet DAMT-së në këshillin e qarkut.

ZMMT-ja, në çdo rast, e njofton kërkuesin me vendimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkisë.

4. Organet e qeverisjes vendore apo institucioni shtetëror i qeverisjes qendrore, që me akte ligjore ose nënligjore është ngarkuar për administrimin/përdorimin e tokës bujqësore, e cila figuron në pronësi të shtetit, për kalimin e saj në kategori të resurseve pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, nëpërmjet DAMT-së të këshillit të qarkut ku ndodhet toka bujqësore, i bën propozim MBUMK-së, i cili përmban:

- identitetin e subjektit të interesuar për kalimin e tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera;
- përshkrimin e qëllimit dhe veprimtarisë që do të ushtrohet në sipërfaqen e kërkuar për kalim;
- fotokopjen e aktit ligjor ose nënligjor, që vërteton qenien në pronësi, administrim apo përdorim të sipërfaqes së tokës për të cilën kërkohet kalimi;
- planimetrinë e sipërfaqes, objekt të propozimit, me kufijtë qartësisht të përcaktuar;
- mendimin e DRBUMK-së dhe DSHP-së për kalimin e propozuar;
- vërtetimin e DAMT-së për kategorinë e tokës sipas bonitetit.

5. DAMT-ja në këshillin e qarkut, verifikon kërkesat apo propozimet e paraqitura sipas pikave 2 dhe 4 të këtij kreu, për saktësinë e përmbajtjes së tyre dhe, kur ato i gjen në përputhje me të dhënat e dokumentacionit kadastral që ajo disponon, ia kalon për shqyrtim këshillit të qarkut, bashkë me një relacion shpjegues, që miratohet nga kryetari.

6. Këshilli i qarkut, në mbledhjen e radhës, e shqyrton kërkesën e pronarit privat të tokës bujqësore apo propozimin e paraqitur nga komuna dhe/ose bashkia për kalimin e tokës bujqësore në pronësi të shtetit, që administrohet apo përdoret prej tyre, në kategori të resurseve të tjera, si: pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh.

Këshilli i qarkut, në orientim të politikave të planifikimit të territorit të qarkut dhe të efektivitetit ekonomik të këtij kalimi, në rast miratimi të kërkesës apo propozimit, ia dërgon atë MBUMK-së.

Kërkesës së këshillit të qarkut i bashkëlidhet kërkesa apo propozimi i subjektit kërkues dhe dokumentacioni përbërës i saj.

DAMT-ja e qarkut, në rast mosmiratimi të kërkesës apo të propozimit, e njofton kërkuesin e saj.

7. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton mbështetjen ligjore, dokumentacionin përbërës, efektivitetin ekonomik që rrjedh nga kalimi, përshtatjen me orientimet e strategjisë së miratuar për bujqësinë etj.

Në çdo rast të vlerësimit pozitiv të kërkesës apo propozimit dhe pasi ka harmonizuar dhe bashkërenduar veprimet me strukturën përkatëse që mbulon administrimin e fondit pyjor dhe kullor në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), përgatit:

a) urdhrin e përbashkët të të dy ministrave, për kalimin e tokës bujqësore në kategorinë e resursit pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, kur sipërfaqja që propozohet për kalim është deri në 1(një) ha;

b) vendimin e Këshillit të Ministrave, si propozim i përbashkët i dy ministrave, kur sipërfaqja e tokës bujqësore që propozohet për kalim është mbi 1(një) ha.

8. Kur ministri vlerëson se në kërkesë apo propozim nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara, që, për pasojë, sjellin mosmiratimin e saj, njofton DAMT-në në këshillin e qarkut.

DAMT-ja, vendimin e ministrit për mosmiratim të kërkesë ia komunikon, me shkrim, kërkuesit të saj.

### III. KALIMI I TOKAVE NGA KATEGORITË E RESURSEVE PYLL, TOKË PYJORE, KULLOTË DHE LIVADH NË KATEGORINË E RESURSIT TOKË BUJQËSORE

1. Procedurat për ndryshimin dhe kalimin e sipërfaqeve të tokës të kategorive të resurseve pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh në tokë bujqësore, në pronësi private apo shtetërore (publike), fillojnë vetëm pasi të jenë kryer analizat e vlerave të treguesve të tokës, që lidhen me nivelin e pjellorisë natyrore të saj.

2. Subjektet e interesuara për kalimin e këtyre kategorive të resurseve në tokë bujqësore paraqesin kërkesën pranë Qendrës të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, (QTTB), Fushë-Krujë, si institucion unik dhe i specializuar në këtë fushë, për kryerjen e analizave të tokës.

Kërkesa përmban:

- identitetin e kërkuesit;
- dokumentin e noterizuar të disponimit të këtyre resurseve në pronësi, administrim / përdorim, sipas ligjit;

- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet ndryshimi, me kufijtë qartësisht të përcaktuar;

- vërtetimin për gjendjen e kategorisë së resursit ku figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral, të lëshuar përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP) apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) në këshillin e qarkut.

3. Kërkesa për kryerjen e analizave të tokës regjistrohet në QTTB. Kësaj kërkesë i bashkëngjitet mandatpagesa që bën subjekti i interesuar, në të cilën përfshihet vlera e analizave, sipas tarifave të miratuara për QTTB-në, dhe shpenzimet për punën e grupit të ekspertëve.

Në shpenzimet e punës së grupit të ekspertëve përfshihen dietat e udhëtimit, sipas dispozitave në fuqi dhe shpenzimet për hapje profilesh dhe marrje mostrash.

Numri i profileve dhe mostrave që merren sipas sipërfaqes që analizohet, si dhe vlerat përkatëse përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Drejtori i QTTB-së krijon grupin e punës për kryerjen e analizave me 3 (tre) ekspertë të këtij institucioni. Në përbërje të këtij grupi marrin pjesë, si anëtarë, edhe një përfaqësues i DAMT-së në këshillin e qarkut dhe përgjegjësi i ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki.

Grupi i ekspertëve kryen analizat, përpunon të dhënat e tyre dhe harton raportin teknik, brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës në QTTB.

Në raportin teknik, grupi i ekspertëve formulon rekomandimet e tij për sipërfaqen e studiuar dhe vlerëson mundësinë e kalimit ose jo të kategorive të resurseve të analizuara në tokë bujqësore.

Një kopje e rezultateve të analizave dhe raportit teknik i jepet ushtruesit të kërkesës, kopja e dytë i dërgohet MBUMK-së, ndërsa kopja e tretë arkivohet në QTTB.

5. Subjekti i interesuar për kalim të kategorive të resurseve tokë pyjore, pyll, kullotë e livadh në tokë bujqësore, pasi ka marrë rezultatet e analizave dhe raportin teknik të QTTB-së, me rekomandimin dhe vlerësimin për mundësinë e kalimit të këtyre resurseve në tokë bujqësore, mund të paraqesë kërkesë në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU). Kërkesa, edhe në rastin e kalimeve të këtyre resurseve në tokë bujqësore, paraqitet sipas përmbajtjes, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes

e të vëllimit të fondit pyjor”, dhe vendimit nr.1374, 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”.

6. MMPAU-ja e shqyrton dhe vlerëson kërkesën dhe, kur e gjykon të përshtatshme, e miraton kalimin e sipërfaqeve të këtyre resurseve në tokë bujqësore.

Në këtë rast, MMPAU-ja përgatit:

a) urdhrin e përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, kur sipërfaqja, objekt i kalimit, është deri në 1 (një) ha;

b) vendimin e Këshillit të Ministrave, si propozim të përbashkët të dy ministrave, kur sipërfaqja, objekt i kalimit në tokë bujqësore, është mbi 1 (një) ha.

#### IV. KALIMI I TOKËS BUJQËSORE NË KATEGORI TË TOKËS SË PAFRYTSHME

1. Subjekti i interesuar për kalimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategorinë e resursit tokë e pafrytshme ka të drejtë propozimi ose kërkesë për kalimin vetëm kur mbi këtë sipërfaqe toke bujqësore kanë vepruar faktorët natyrorë të fuqisë madhore, si tërmete, rrëshqitje masive të sipërfaqeve së tokës, përmytje, vullkane, zjarre masive, fundosje të shtresave të tokës dhe të tjerë faktorë të kësaj natyre.

Veprimi i faktorëve natyrorë të fuqisë madhore kërkohet të jetë i dokumentuar me procesverbalin e kohës së dëmtimit, të konfirmuar (nënshkruar) nga specialisti i DRBUMK-së, inspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës (IMT) në qark, si dhe përgjegjësi i ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki, ose të jetë i dokumentuar nga IMT-ja sipas procedurave të përcaktuara në pikat 5 deri në 8 të kreut IV të vendimit nr.80, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”.

2. Dëmtimi i tokës bujqësore nga faktorë të fuqisë madhore, të evidentuara sipas pikës 1 të këtij kreu, verifikohet nëpërmjet analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore, që kryhen nga QTTB-ja, sipas përcaktimeve në pikat 1 deri 4 të kreut III të këtij vendimi.

Kërkesës për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës, veç përmbajtjes së përcaktuar në pikën 2 të kreut III të këtij vendimi, i shtohet edhe dokumentacioni që evidenton dëmtimin e tokës, i mbajtur sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij kreu.

3. Subjekti i interesuar për kalimin e tokës në kategori të resursit tokë e pafrytshme, në varësi të rezultateve të analizave, raportit teknik dhe rekomandimeve të QTTB-së, mund të paraqesë kërkesë për miratimin e këtij kalimi.

Kur subjekti rezulton të jetë:

a) Pronar privat i tokës bujqësore, objekt i kërkesës për kalim në tokë të pafrytshme, kërkesën e paraqet në komunë dhe/ose bashki.

Këshilli i komunës dhe/ose bashkisë e shqyrton kërkesën dhe ndjek procedurat e përcaktuara në pikën 3 të kreut II të këtij vendimi.

b) Komunë dhe/ ose bashki apo institucion shtetëror i qeverisjes qendrore, që me akte ligjore ose nënligjore është ngarkuar për administrim/përdorimin e tokës bujqësore, e cila figuron në pronësi të shtetit, kërkesën e paraqet në DAMT-në e këshillit të qarkut në juridiksion të të cilit ndodhet kjo tokë.

Kërkesat, në të dy rastet, bëhen me shkrim dhe përmbajnë dokumentacionin sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij kreu.

4. DAMT-ja në këshillin e qarkut, i verifikon kërkesat apo propozimet e paraqitura, për saktësinë e përmbajtjes së tyre, dhe, kur ato i gjen në përputhje me të dhënat e dokumentacionit kadastral që ajo disponon dhe sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij kreu, ia kalon për shqyrtim këshillit të qarkut, bashkë me një relacion shpjegues, që miratohet nga kryetari.

5. Këshilli i qarkut, në mbledhjen e radhës, e shqyrton kërkesën e pronarit privat të tokës bujqësore apo propozimin e paraqitur nga komuna dhe/ose bashkia apo institucioni tjetër shtetëror që, bazuar në aktet ligjore ose nënligjore, e ka këtë tokë në administrim/përdorim, dhe, në rast miratimi ia dërgon atë MBUMK-së.

DAMT-ja e qarkut, në rast mosmiratimi të kërkesës apo të propozimit, e njofton kërkuuesin përkatës.

6. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton mbështetjen ligjore të kërkesës apo propozimit dhe dokumentacionin përbërës të tij.

Në rastin e vlerësimit pozitiv të kërkesës apo propozimit, MBUMK përgatit:

a) vendimin e Këshillit të Ministrave, kur sipërfaqja e propozuar është deri në 30 (tridhjetë) ha;

b) ligjin, kur sipërfaqja e propozuar është mbi 30 (tridhjetë) ha.

Kur ministri vlerëson se në kërkesë apo propozim nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara, që sjellin, për pasojë, dhe mosmiratimin e saj, njofton DAMT-në në këshillin e qarkut.

DAMT-ja në këshillin e qarkut, vendimin e ministrit për mosmiratim të kërkesës, ia komunikon, me shkrim, kërkuetit të saj.

#### V. KALIMI I TOKËS SË PAFRYTSHME NË KATEGORI TË RESURISIT TOKË BUJQËSORE

1. Subjekti i interesuar për kalim të tokës së pafrytshme në kategori të resursit tokë bujqësore ka për detyrë:

a) të kryejë procedurat e përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të kreut III të këtij vendimi;

b) pasi ka marrë rezultatet e analizave dhe raportin teknik nga QTTB-ja, me rekomandimin dhe vlerësimin për mundësinë e kalimit të sipërfaqes së tokës së pafrytshme në tokë bujqësore, i drejtohet me kërkesë komunës dhe/ose bashkisë.

Kërkesa përmban:

- identitetin e kërkuetit;

- përshkrimin e veprimtarisë që do të ushtrojë në sipërfaqen e kërkuar për kalim dhe efektet ekonomiko-financiare të këtij kalimi;

- fotokopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë mbi tokën;

- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet kalimi me kufijtë e saj qartësisht të dallueshëm, në shkallën 1:2500 ose 1:5000;

- mendimin e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DRBUMK) për kalimin e kërkuar.

2. Këshilli i komunës dhe/ose bashkisë dhe DAMT-ja në këshillin e qarkut zbatojnë procedurat e përcaktuara në pikat 3 deri 6 të kreut II të këtij vendimi.

3. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton mbështetjen ligjore të kërkesës apo propozimit, dokumentacionin përbërës, efektivitetin ekonomik që rrjedh nga ky kalim, përshatjen me orientimet e strategjisë së miratuar për zhvillimin e bujqësisë etj.

Në rastin e vlerësimit pozitiv të kërkesës apo propozimit, MBUMK-ja përgatit:

a) vendimin e Këshillit të Ministrave, kur sipërfaqja e propozuar është deri në 30 (tridhjetë) ha;

b) ligjin, kur sipërfaqja e propozuar është mbi 30 (tridhjetë) ha.

Kur ministri vlerëson se, në kërkesë apo propozim, nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara, që sjellin, për pasojë, mosmiratimin e saj, njofton DAMT-në në këshillin e qarkut.

#### VI. NDRYSHIMI I TOKAVE BUJQËSORE TË KATEGORIVE NGA V DERI NË X TË BONITETIT DHE KALIMI I TYRE NË TOKË URBANE (TRUALL), NË TOKË PËR VEPRIMTARI MINERARE E GJEOLGJIKE, SI DHE GURORRE E KARIERA

1. Subjektet e interesuara për ndryshim të kategorisë së resursit të tokës bujqësore, nga V deri në X të bonitetit, për kalimin e tyre në tokë urbane (truall), në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore dhe karriera, paraqesin kërkesë në ministrinë përkatëse që mbulon këtë veprimtari. Kërkesa paraqitet sipas dispozitave të legjislacionit për planifikimin e territorit.

Kërkesa përmban edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit për sipërfaqen objekt kërkesë, të lëshuar nga DAMT-ja në këshillin e qarkut.

2. Ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse, merr paraprakisht mendimin e MBUMK-së dhe përgatit vendimin e Këshillit të Ministrave, kur kërkesa ka për objekt sipërfaqe toke deri 30 (tridhjetë) ha, apo ligjin, kur kërkesa ka për objekt sipërfaqe toke mbi 30 (tridhjetë) ha.



## VII. KALIMI I TOKAVE BUJQËSORE TË KATEGORIVE NGA I DERI NË IV PËR NDËRTIME, PËR RASTE TË DOMOSDOSHME

1. Subjektet e interesuara për të ushtruar veprimtari në tokat bujqësore të kategorisë nga I deri në IV të bonitetit, vetëm për rastet e domosdoshme, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 11/1 të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, paraqesin kërkesë në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas dispozitave që rregullojnë veprimtaritë për planifikimin e territorit.

Kërkesa duhet të përmbajë edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit, të lëshuar nga DAMT-ja e këshillit të qarkut.

2. Ministria përkatëse që mbulon veprimtarinë, merr paraprakisht mendimin e MBUMK-së dhe përgatit vendimin e Këshillit të Ministrave.

## VIII. PËRDITËSIMI NË DOKUMENTACIONIN KADASTRAL TË KALIMEVE DHE NDRYSHIMEVE TË KATEGORIVE TË RESURSEVE

1. DAMT-ja në këshillin e qarkut, ZMMT-ja në komunë dhe/ose bashki, DSHP-ja e rrethit, për kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve, të miratuara sipas rastit, me akte ligjore apo nënligjore, dhe bazuar në këto akte bëjnë përditësimin në dokumentacionin kadastral përkatës.

2. DAMT-ja në këshillin e qarkut dhe DSHP-ja në rreth, për kalimet dhe ndryshimet e miratuara me akte ligjore apo nënligjore njoftojnë zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rreth, e cila i pasqyron këto ndryshime në llojet e pasurive, sipas pronarëve ose poseduesve të ligjshëm të tyre.

## IX. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Kreu III “Procedurat për ndryshimin e kategorizimit të resurseve” i vendimit nr.532, datë 31.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjet së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe strukturat shtetërore të administrimit të tokës në qarqe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

## VENDIM Nr.656, datë 28.7.2010

### **PËR PËRCAKTIMIN E DETYRAVE, PËRGJEGJËSIVE TË BORDIT TË QIRADHËNIES, PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PAKULTIVUARA DHE KONTRATËS TIP TË QIRADHËNIES SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

### **I. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E BORDIT TË QIRADHËNIES TË TOKAVE BUJQËSORE TË PAKULTIVUARA (MË POSHTË BQ)**

BQ krijohet dhe funksionon në çdo komunë dhe/ose bashki, me përbërjen e përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr. 10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”, dhe ka për detyrë e mban përgjegjësi për:

a) ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, të ligjit nr.10 263, datë 8.4.2010 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) njoftimin për dhënien me qira të tokave bujqësore të pakultivuara, brenda afateve të parashikuara në këtë vendim;

c) garantimin e një konkurrence, të lirë dhe të barabartë ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse të ankandit të dhënies me qira të tokave bujqësore të pakultivuara;

ç) përcaktimin e fituesit të ankandit të dhënies me qira të tokave bujqësore të pakultivuara.

## II. NJOFTIMI PËR QIRADHËNIEN E TOKAVE BUJQËSORE TË PAKULTIVUARA

1. Njoftimi për dhënien me qira të tokave bujqësore të pakultivuara shpallet në një vend të dukshëm të fshatit, në qendrën e komunës dhe/ose bashkisë dhe, kur është e mundur, bëhet edhe në mediat lokale.

Ky njoftim përmban:

- vendndodhjen e tokave (fshati ku shtrihet);
- numrin kadastral ose numrin e pasurisë së ngastrës (parcelës) që jepet me qira;
- madhësinë e sipërfaqes së ngastrës/pronësisë;
- identitetin e pronarit apo poseduesit të ligjshëm të tokës;
- kohëzgjatjen (në vite) të dhënies së tokës me qira;
- kategorinë e sipërfaqes së tokës që jepet me qira, sipas bonitetit.

2. Të gjitha komunat dhe/ose bashkitë e vendit, njoftimin për qiradhënien e tokave bujqësore të pakultivuara e shpallin brenda datës 6 shkurt, me kohë zgjatjeje të tij deri në 15 ditë.

Personat fizikë apo juridikë i paraqesin kërkesat, me shkrim, për qiramarrje të tokave bujqësore të pakultivuara brenda datës 25 shkurt.

3. Komuna dhe /ose bashkia, njofton, me shkrim, sipas adresave të shënuara në kërkesë, të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kanë ushtruar kërkesë për qiramarrje të tokave bujqësore të pakultivuara për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të ankandit të qiradhënies së tokave.

Ky njoftim bëhet brenda muajit shkurt.

Periudha e zhvillimit të ankandit është e njëjtë për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore dhe fillon më 1 mars e mbaron më 20 mars të çdo viti.

Data e zhvillimit të ankandit për çdo komunë dhe/ose bashki, brenda periudhës së përcaktuar për zhvillimin e tyre, propozohen nga secili kryetar komune dhe/ose bashkie dhe grafiku i zhvillimit të tyre koordinohet me drejtorin e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave (DAMT) të qarkut, i cili cakton edhe punonjësit e këtij institucioni si pjesëmarrës në përbërje të BQ-së për çdo komunë dhe/ose bashki.

## III. PARAQITJA E OFERTAVE PËR QIRAMARRJE TË TOKAVE BUJQËSORE TË PAKULTIVUARA

1. Konkurruesit për marrje me qira të tokave bujqësore të pakultivuara, persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, i paraqesin ofertat e tyre për qiramarrje në afatin e përcaktuar në pikën 2, të kreut II të këtij vendimi.

Për çdo parcelë (ngastër) apo tokë në pronësi oferta paraqitet e veçantë.

Në çdo rast kur në komunë dhe/ose bashki paraqiten oferta pas afatit të sipërshënuar, mund të zhvillohet një ankand tjetër në periudhën 20 prill deri në 10 maj të atij viti.

2. Oferta, e mbyllur në zarf, i paraqitet sekretarit të komunës dhe/ose bashkisë, i cili i regjistron këtë me numër të veçantë.

Sekretari i komunës dhe/ose bashkisë i kërkon ofertuesit që, në zarfin e mbyllur, të paraqitur për konkurrim, të shënojë:

a) në faqen ballore, të jashtme:

- numrin e parcelës (ngastrës) apo pronësisë për të cilën konkurron;

- vendndodhjen (fshatin) ku shtrihet parcela/prona për të cilën ushtron kërkesën për qiramarrje;

b) në faqen e pasme, të jashtme:

- identitetin, vendbanimin dhe numrin e telefonit të tij.

3. Oferta e mbyllur në zarf përmban:

- identitetin e kërkuarit dhe vendbanimin (qëndrimin) e tij;
- ngastrën (parcelën) apo pronësinë që kërkon ta marrë me qira, të identifikuar me numrin e saj kadastral ose të pronësisë, si dhe vendndodhjen (fshatin) ku shtrihet ngastra;
- kulturën apo kulturat bujqësore që do të mbillen në tokën e kërkuar për qiramarrje;
- afatin (në vite) të qiramarrjes së tokës;
- nivelin e vlerës vjetore, lekë/ha, me të cilën kërkon qiramarrjen.

4. Një person fizik ose juridik, mund të konkurrojë për një ose më shumë ngastra (parcela)/pronësi brenda të njëjtit fshat, si dhe në fshatra të tjera brenda juridiksionit të komunës dhe/ose bashkisë.

#### IV. PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË OFERTAVE DHE VENDIMARRJA

1. BQ-ja e komunës dhe/ose bashkisë mbledhet me pjesëmarrje të plotë të anëtarëve, në datën, orën dhe vendin e caktuar në njoftim.

Shqyrtimi i kërkesave për qiramarrjen dhe vendimet e BQ-së kanë vlefshmëri ligjore vetëm kur këto merren me praninë e të gjithë anëtarëve të tij, sipas përbërjes së caktuar me ligj.

Veç anëtarëve të BQ-së, në hapjen e ofertave marrin pjesë të gjithë ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre, të pajisur me prokurë dhe dokument identifikimi, të cilët konkurrojnë për qiramarrje të tokave bujqësore të pakultivuara të fshatit përkatës ku ndodhen këto toka.

2. BQ-ja, pasi mbaron shqyrtimin e të gjitha kërkesave në një fshat, tërhiqet për të marrë vendim pa pjesëmarrjen e konkurruesve.

Zhvillimi i kësaj procedure vijon radhazi për çdo fshat të juridiksionit të komunës dhe/ose bashkisë.

3. BQ-ja vlerëson me përparësi ofertuesin që ka përcaktuar nivelin më të lartë të vlerës vjetore të qirasë, lekë/ha, në raport me kufirin më të ulët (çmimin dysheme), të përcaktuar në nenin 15 të ligjit nr. 10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”.

Kur rezultojnë dy ose më shumë oferta me të njëjtin nivel qiraje të vlerës vjetore, lekë/ha, për të njëjtën parcelë (ngastër)/pronë, bordi e vlerëson si fituese ofertën që ka kohëzgjatje më të madhe të qiramarrjes (në vite).

Kur edhe ky tregues, në dy ose më shumë oferta rezulton i njëjtë, bordi organizon hedhjen e shortit ndërmjet konkurruesve.

4. BQ-ja shpall vendimet e ankandit dhe ua komunikon pjesëmarrësve në ankand brenda 5 (pesë) ditëve, nga data e zhvillimit të ankandit.

Vendimet në BQ merren kur për to votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve.

5. Konkurruesit në ankand kanë të drejtë ankimi te kryetari i komunës dhe/ose bashkisë ndaj vendimit të dhënë nga BQ-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dalja e vendimit.

Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë e shqyrton ankesën brenda 10 (dhjetë) ditëve.

6. Kundër vendimit të kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë, konkurruesit mund të ushtrojnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ndodhet toka.

#### V. QIRADHËNIA PA ANKAND E TOKAVE BUJQËSORE TË PAKULTIVUARA

1. Kur për një ngastër (parcelë) apo tokë në pronësi është paraqitur vetëm një ofertë, BQ-ja, me përbërje të plotë, shqyrton ofertën e paraqitur.

2. Mbledhja e BQ-së, marrja e vendimit dhe shpallja e tij bëhet sipas afateve procedurale të përcaktuara në kreun II të këtij vendimi.

3. Niveli i vlerës së qiradhënies vjetore, lekë/ha, vendoset sipas kërkesës së ushtruar, por jo më i ulët se kufiri i përcaktuar (çmimi dysheme) në nenin 15 të ligjit nr 10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”.

#### VI. LIDHJA E KONTRATËS, FORMA DHE PËRMBAJTJA

1. Ndërmjet komunës dhe/ose bashkisë, si autoritet qiradhënës, të përfaqësuar nga kryetari, dhe fituesit të ankandit ose kërkuarit të marrjes me qira të tokës bujqësore të pakultivuar, nënshkruhet kontrata me përmbajtjen dhe formën sipas lidhjes nr. 1 të këtij vendimi.

2. Në rastin kur personi i shpallur fitues nga BQ-ja refuzon lidhjen e kontratës, ftohet, për lidhjen e kontratës, fituesi i vendit të dytë, të tretë e kështu me radhë.

3. Në kontratë, te elementi “Objekti” pasqyrohen një për një të gjitha parcelat (ngastrat) apo pronësitë për të cilat lidhet kontrata ndërmjet palëve.

4. Dokumentacioni i dhënies me qira të tokave bujqësore të pakultivuara ruhet, në mënyrë të përhershme, pranë komunës dhe/ose bashkisë.

#### VII. DISPOZITA E FUNDIT

Ngarkohen kryetarët e komunave dhe/ose bashkive, drejtorët e DRBUMK-ve, DAMT-të në këshillat e qarqeve, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr. 1

### KONTRATË TIP PËR DHËNIE ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE TË PAKULTIVUAR

Kjo kontratë lidhet sot, më datën \_\_\_\_\_ ndërmjet palëve:

1. Komuna/bashkia \_\_\_\_\_, e përcaktuar si autoriteti i qiradhënies nga neni 12 i ligjit nr. 10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”, përfaqësuar nga kryetari i komunës/bashkisë,

z. \_\_\_\_\_ ( më poshtë do të quhet “ Qiradhënësi”)

dhe

z. \_\_\_\_\_ ( identiteti i plotë i personit fizik ose juridik, subjekti i marrjes së tokës me qira; më poshtë do të quhet “Qiramarrësi”).

Objekt i kësaj kontrate janë:

Parcelat (ngastrat) apo pronësitë e tokës bujqësore të pakultivuar, pasuri private, çdo njëra prej të cilave identifikohet me këta tregues:

1. Parcela (ngastra) apo pronësia:

- nr. kadastral \_\_\_\_\_; nr. pasurisë \_\_\_\_\_;

- kategoria e tokës sipas bonitetit \_\_\_\_\_.

- sipërfaqja që jepet me qira \_\_\_\_\_ ha,

- vendndodhja ( fshati \_\_\_\_\_, komuna \_\_\_\_\_, rrethi \_\_\_\_\_,  
bashkia \_\_\_\_\_)

Toka rezulton në pronësi të ligjshme të:

z. \_\_\_\_\_, i cili, sipas përcaktimeve të nenit 8 të ligjit nr 10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”, nuk ka marrë përsipër kultivimin e kësaj sipërfaqeje.

2. Parcela (ngastra) apo pronësia:

- nr. kadastral \_\_\_\_\_; nr. pasurisë \_\_\_\_\_;

- kategoria e tokës sipas bonitetit \_\_\_\_\_.

- sipërfaqja që jepet me qira \_\_\_\_\_ ha,

- vendndodhja ( fshati \_\_\_\_\_, komuna \_\_\_\_\_, rrethi \_\_\_\_\_,  
bashkia \_\_\_\_\_)

Toka rezulton në pronësi të ligjshme të:  
z. \_\_\_\_\_, i cili, sipas përcaktimeve të nenit 8 të ligjit nr 10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”, nuk ka marrë përsipër kultivimin e kësaj sipërfaqeje.

3.....  
.....

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Komuna/bashkia \_\_\_\_\_, në bazë të vendimit të Bordit të Qiradhënies (BQ) të tokave të pakultivuara,

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

i jep me qira, z. \_\_\_\_\_ (identiteti i plotë i personit fizik ose juridik), tokën bujqësore të pakultivuar, të identifikuar më sipër në kontratë tek paragrafi “Objekti”.

2. Palët kontraktore hartojnë dhe lidhin këtë kontratë, në përputhje me ligjin nr.10 263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”, të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “ Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826 deri 840 të tij, të ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

#### DISPOZITA TË VEÇANTA

Qiradhënësi merr përsipër:

1. Në bazë të vendimit të BQ-së i dorëzon sipërfaqen e tokës, objekt i kësaj kontrate, në sipërfaqe prej \_\_\_\_\_ ha.

Kontratës i bashkëlidhet planimetria përkatëse e sipërfaqes së tokës së dhënë me qira .

2. T’i garantojë qiramarrësit përfshirjen e sipërfaqes së tokës në programet/projektet e zhvillimit rajonal me kushte të barabarta me të gjitha pronat tokë bujqësore që posedohen nga pronarët e tjerë të ligjshëm .

3. T’i përballojë detyrimet e taksës vendore mbi tokën e dhënë me qira sipas përcaktimit të nenit 17 të ligjit nr. 10263, datë 8.4.2010 “ Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”.

4. Të ushtrojë kontrolle periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore dhe zbatimin e dispozitave të legjislationit për mbrojtjen e tokës.

Para fillimit të kontrollit, të njoftojë qiramarrësin dhe në fund të çdo kontrolli t’i dorëzojë procesverbalin me detyra konkrete dhe të bazuara në ligj.

5. Në çdo rast, kur konstaton se qiramarrësi e ka dhënë tokën me nënqira pa pëlqimin e tij, kërkon prishjen e kontratës.

Qiramarrësi merr përsipër:

1. Kryerjen e pagesës së vlerës së qiramarrjes së tokës.

Pagesa, për vitin e parë të qiradhënies, kryhet e plotë në datën e lidhjes së kontratës.

Pagesat për vitet e tjera bëhet në fund të çdo viti.

2. T’i sigurojë qiradhënësit se:

a) toka do të përdoret vetëm për veprimtari bujqësore, për kultivimin të bimëve të arave;

b) do të ruhet kategorizimi i resursit “tokë bujqësore”;

c) do të zbatohet një praktikë të mirë bujqësore të përcaktuar në nenin 16 të ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 “ Për mbrojtjen e tokës bujqësore” dhe toka do të shfrytëzohet mbi të drejtën e përcaktuar në nenin 17 të ligjit të sipërcituar;

d) do të ruajë nga dëmtimet çdo objekt (send) të paluajtshëm që ndodhet brenda kufijve të tokës së marrë me qira;

e) në asnjë rast nuk do të aplikojë për dhënie me nënqira të tokës bujqësore;

f) do të përballojë shpenzimet e kultivimit të bimëve dhe të mirëmbajtjes së tokës të marrë me qira gjatë gjithë periudhës për të cilën është nënshkruar kontrata.

#### DETYRIME TË PËRBASHKËTA TË TË DY PALËVE

1. Pretendimet e njërës palë për ndryshim të kushteve të kontratës, i paraqiten palës tjetër 180 ditë para se të kërkohet zbatimi i veprimit të kërkuar.

2. Kalimi i pjesshëm ose i plotë i tokës bujqësore të pakultivuar, të dhënë me qira, në tokë urbane sipas miratimit të strukturave shtetërore që kanë tagrin ligjor të vendimmarrjes për këtë kalim, nuk mund të bëhet më shpejt se afati përfundimtar i korrjes dhe grumbullimit të prodhimeve të bimëve të mbjella në këtë sipërfaqe. Në çdo rast të vendimmarrjeve të mësipërme, qiradhënësi detyrohet të kompensojë qiramarrësin me dëmin e shkaktuar nga prishja e kontratës në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil dhe ligjeve të tjera të veçanta.

Afati i qirasë: Fillon (data, muaji, viti)\_\_\_\_\_ dhe mbaron (data, muaji, viti)\_\_\_\_\_.

#### SANKSIONE

1. Qiradhënësi paguan gjobë 1% të çmimit të qiradhënies për çdo ditë vonese në dorëzimin e tokës, duke filluar nga data e përcaktuar në procesverbal për dorëzimin e tokës dhe të shënuar në këtë kontratë.

2. Qiramarrësi paguan gjobë 1% të detyrimit për çdo ditë vonese në pagesën e qirasë të përcaktuar në kushtet e kësaj kontrate.

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Ndërmjet palëve, çdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e detyrimeve ose interpretimin e kushteve të kësaj kontrate, në rast se nuk zgjidhet me mirëkuptim, çështja i paraqitet për gjykim gjykatës së rrethit në juridiksion të të cilit ndodhet toka bujqësore.

Kjo kontratë bëhet në 4 kopje me vlerë të barabartë.

#### PËR PALËT KONTRAKTUESE

Qiradhënësi ( ) Qiramarrësi ( )

#### VENDIM Nr.663, datë 4.8.2010

#### **PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.584, DATË 27.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE DHE TË TË MBIJETUARVE TË AKSIDENTIT RRUGOR, TË DATËS 17.7.2010, NË AKSIN RRËSHEN-FUSHË-ARRËZ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” dhe të neneve 31, pika 1 e 32, shkronja “a” të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr.584, datë 27.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, vlera e fondit prej 21 100 000 (njëzet e një milionë e njëqind mijë) lekësh, të zëvendësohet me 22 050 000 (njëzet e dy milionë e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Në shkronjën “a” të pikës 1 vlera e fondit prej 16 750 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, të zëvendësohet me 17 700 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekë.

3. Në listat bashkëlidhur vendimit, bëhet ndryshimi si vijon:

a) Në listën me emrat e viktimave të aksidentit rrugor, në aksin Rrëshen –Fushë-Arrëz, të datës 17.7.2010, shtohet emri i viktimës Erikson Gjini Peraj.

b) Në listën me emrat e të mbijetuarve të aksidentit rrugor, në aksin Rrëshen-Fushë-Arrëz, të datës 17.7.2010 të hiqet emri Erikson Gjini Peraj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

## VENDIM Nr.666, datë 4.8.2010

### **PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.314, DATË 5.5.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË PERSONAVE TË TRETË NË ADMINISTRIMIN E PASURISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15, pika 2, e 34/2 të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr.314, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

1. Në fjalinë e fundit të pikës 5 të kreut I, shprehja “...në përputhje me nenin 20 të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009...”, shfuqizohet.

2. Shkronjat “c” dhe “e” të pikës 2 të kreut II, ndryshohen si më poshtë vijon:

“c) në përputhje me kriteret e parashikuara në pikën 3 të këtij kreu, i paraqet Gjykatës për Krime të Rënda listën e administratorëve të pasurive të sekuestruara/konfiskuara, sipas dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, lidh kontratën e punës me administratorin, brenda 30 ditëve nga data e emërimit nga Gjykata;

miraton dhe lidh kontratën e punës me punonjësit mbështetës, të propozuar nga administratori.”.

“e) është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin, brenda datës 30 dhjetor të çdo viti, të raportit vjetor të administrimit të të gjitha pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, si edhe për administrimin e pasurive të tjera, të cilat janë produkt 6596

i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj agjencie, me ligj apo me një akt tjetër nënligjor.”.

3. Pas shkronjës “g” të pikës 2 të kreut II, shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) lidh kontratat e punës për administrimin e pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, si dhe për administrimin e pasurive të tjera, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj agjencie, me ligj apo me një akt tjetër nënligjor.”.

4. Pika 3 e kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Administratori/administratorët e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, sipas dispozitave të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, zgjidhen nga gjykata, sipas listës së paraqitur nga kryeadministratori. Administratori/administratorët e pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, si dhe të pasurive të tjera, administrimi i të cilave i caktohet kësaj agjencie, me ligj apo me një akt tjetër nënligjor, përzgjidhen nga kryeadministratori, nga e njëjta listë e paraqitur në gjykatë.”.

5. Pas pikës 3 të kreut III, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Pagesa e administratorit të pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, si dhe të pasurive të tjera, administrimi i të cilave i caktohet kësaj agjencie, me ligj apo me një akt tjetër nënligjor, miratohet, rast pas rasti, nga Ministri i Financave, pas propozimit të kryeadministratorit. Pagesa e personave të tjerë, të punësuar në agjenci, përcaktohet nga Ministri i Financave, në përputhje me organikën dhe strukturën e miratuar nga Kryeministri.”.

6. Në kreun VI “Dispozita të fundit”, shtohet pika 3, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“3. Kontratat e lidhura me administratorët e pasurive dhe personat ndihmës, vijnë në efektet ligjore deri në përfundimin e tyre. Me përfundimin e afateve, zëvendësohen, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.667, datë 4.8.2010**

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË TRE ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR  
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT E TË  
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Emërimin anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për një mandat 4-vjeçar, të tre kandidaturave të përzgjedhura nga ekipi përzgjedhës, si më poshtë vijon:

- Arjan Jovani, inxhinier;
- Altin Uka, inxhinier;
- Aida Gojani, ekonomiste.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.668, datë 4.8.2010**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2010, PËR  
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS RINISË DHE SPORTEVE, PËR REALIZIMIN E  
VEPRIMTARIVE KUSHTUAR 100-VJETORIT TË LINDJES SË NËNË TEREZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 24 928 000 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e njëzet e tetë mijë) lekësh, për realizimin e veprimtarive në kuadër të festimeve të 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezës.
  2. Efektet financiare të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.669, datë 4.8.2010**

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË  
KONSUMATORIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR, PËR TË KRYER PROCEDURAT E  
PROKURIMIT PËR OBJEKTET “INVESTIM PËR SKEMËN E ULLIRIT, SERA  
PRODHIM FIDANËSH” DHE “THELLIM I SHTRATIT TË LUMIT DEVOLL (URA E  
MALIQIT), KORÇË” DHE PËR TË LIDHUR KONTRATAT PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si autoritet kontraktor, për të kryer procedurat e prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti për objektet “Investim për skemën e ullirit, sera prodhim fidanësh”, me fond limit 58 600 000 (pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë dhe “Thellim i shtratit të lumit Devoll (Ura e Maliqit), Korçë”, me fond limit 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, si dhe për të lidhur kontratat përkatëse.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

VENDIM

Nr.671, datë 13.8.2010

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MOLDAVISË  
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ISLAMIKE TË PAKISTANIT, PËR LEHTËSIMIN E  
PASOJAVE, TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e vitit 2010, t’i shtohet fondi prej 80 000 (tetëdhjetë mijë) eurosh, kundërvlera në lekë, për dhënie ndihme financiare, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga përmbytjet, përkatësisht:

- Qeverisë së Republikës së Moldavisë, 30 000 (tridhjetë mijë) euro;
- Qeverisë së Republikës Islamike të Pakistanit, 50 000 (pesëdhjetë mijë) euro.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.37, datë 28.7.2010**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR RADIO**  
**“NGJALLJA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Ngjallja”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.45, datë 28.7.2010**

**MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK**  
**PRIVAT VENDOR “RADIO X”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti radiofonik privat vendor “Radio X”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 dhe neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, vendimi nr.845, datë 24.4.2009 i KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**VËREN SE:**

Në bazë të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të

operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, shoqëria “X” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin për rinovim licence për radion private vendore “Radio X”.

Me vendimin nr.845, datë 24.4.2009, KKRT ka vendosur paraprakisht mosrinovimin e licencës për subjektin “Radio X”, si rrjedhojë e mosparaqitjes së kontratave të punës dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për personat e punësuar dhe objektit jo ekskluziv të veprimtarisë.

Megjithatë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.12.2009, pasi mori në shqyrtim aplikimet për rinovim licence të disa subjekteve, mes të cilave edhe “Radio X”, vendosi që të gjitha subjektet të njoftohen për të plotësuar një sërë mangësish të konstatuara, duke u lënë në dispozicion një afat të caktuar.

Në bazë të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, rregullores “Mbi rilicencimin e operatorëve radio e televizivë” dhe urdhrin nr.35 të kryetarit të KKRT-së, më datë 22.2.2010, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit u mbledh për të shqyrtuar plotësimet e depozituara në KKRT nga subjektet.

Nga verifikimi përkatës, rezulton se subjekti “Radio X” nuk ka depozituar plotësimet e kërkuara për rinovimin e licencës. Konkretisht, ekstrakti i QKR-së mungon; plani ekonomiko-financiar i pafirmosur dhe i pavulusur; të dhënat mbi kapitalin financiar janë depozituar të fotokopjuara; nuk identifikohet inxhinieri i projektit teknik; të dhënat mbi programet janë të pafirmosura dhe të pavulosura; CV-të e anëtarëve të Bordit Drejtues janë të pafirmosura prej tyre; nuk janë paraqitur kontratat e punës dhe vërtetimi për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për personat e punësuar. Gjithashtu, subjekti nuk ka depozituar në KKRT asnjë bilanc financiar për kohën e vlefshmërisë së licencës.

Për sa më sipër, subjektit “Radio X” nuk mund t’i jepet akoma mundësia për të depozituar plotësimet përkatëse për mangësitë e konstatuara.

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe 33 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

#### VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.066/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio X”.
  2. Licenca me nr.066/FML bëhet e pavlefshme.
  3. Subjekti, sipas pikës 1, të ndërpresë menjëherë transmetimin.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.46, datë 28.7.2010**

**MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK**  
**PRIVAT VENDOR “RADIO 6”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti radiofonik privat vendor “Radio 6”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 dhe neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimi nr.746, datë 30.1.2009 i KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

**VËREN SE:**

Në bazë të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, z.Aqif Haveriku, person fizik, ka paraqitur dokumentacionin për rinovim licence për radion private vendore “Radio 6”.

Me vendimin nr.746, datë 30.1.2009, KKRT ka vendosur paraprakisht mosrinovimin e licencës për subjektin “Radio 6”, si rrjedhojë e mosparaqitjes të kontratave të punës, mosshlyerjes së pagesës për përpunimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës, mosparaqitjes së të dhënave të kapitalit, mosdepozitimit të pyetësorëve për vitet e licencimit dhe të garancisë bankare në masën 10%.

Megjithatë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.12.2009, pasi mori në shqyrtim aplikimet për rinovim licence të disa subjekteve, mes të cilave edhe “Radio 6”, vendosi që të gjitha subjektet të njoftohen për të plotësuar një sërë mangësish të konstatuara, duke u lënë në dispozicion një afat të caktuar.

Në bazë të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, rregullores “Mbi rilicencimin e operatorëve radio e televizivë” dhe urdhrin nr.35 të kryetarit të KKRT-së, më datë 22.2.2010, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit u mblodh për të shqyrtuar plotësimet e depozituara në KKRT nga subjektet.

Nga verifikimi përkatës, rezulton se subjekti “Radio 6” nuk ka depozituar plotësimet e kërkuara për rinovimin e licencës. Konkretisht, ekstrakti i QKR-së mungon; të dhënat mbi programet janë të pafirmosura; CV-të e Bordit Drejtues janë të pafirmosura; nuk identifikohet inxhinieri i projektit teknik; nuk janë paraqitur kontratat e punës. Gjithashtu, subjekti nuk ka depozituar në KKRT asnjë pyetësor (pasqyrat financiare) për kohën e vlefshmërisë së licencës.

Për sa më sipër, subjektin “Radio 6” nuk mund t’i jepet akoma mundësia për të depozituar plotësimet përkatëse për mangësitë e konstatuara.

## PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe 33 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

### VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.065/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio 6”.
  2. Licenca me nr.056/FML bëhet e pavlefshme.
  3. Subjekti, sipas pikës 1, të ndërpresë menjëherë transmetimin.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

### VENDIM

**Nr.47, datë 28.7.2010**

#### **MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “AVN”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “AVN”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 dhe neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimi nr.515, datë 9.10.2006 i KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

### VËREN SE:

KKRT, me vendimin nr.279, datë 29.10.2004, ka licencuar shoqërinë “AVN+15”, sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor në qytetin e Fierit, për një periudhë prej 6 vjetësh. Për shkelje të dispozitave të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, KKRT, me vendimin nr.515, datë 9.10.2006, vendosi të reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës

në masën 50% të afatit të saj. Afati i vlefshmërisë së licencës për subjektin televiziv privat kabllor AVN ka përfunduar më datë 12.11.2007.

Në mbledhjen e datës 14.11.2007, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit vendosi të mos hapë aplikimin për rinovimin e licencës për TV kabllor AVN, duke ia kaluar për shqyrtim KKRT-së, pasi ky subjekt e kishte paraqitur dosjen e aplikimit pas përfundimit të afatit të përcaktuar në shkresën nr.745 prot., datë 11.7.2007 të KKRT-së.

Në mbledhjen e datës 26.2.2008, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit vendosi të shqyrtojë aplikimin për rinovimin e licencës për TV kabllor AVN, pasi më parë KKRT kishte rënë dakord në mbledhjen e saj të radhës, që këtij subjekti t'i hapej dosja e rinovimit të licencës. Në fazën e parë të shqyrtimit të dosjes, TV kabllor AVN nuk arriti të kualifikohet, pasi ky subjekt kishte detyrime financiare të pashlyera.

Bazuar në vendimin nr.704, datë 16.7.2008, KKRT vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës për subjektin "TV kabllor AVN", për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare. Pas shlyerjes së detyrimeve financiare, KKRT vendosi që të shqyrtojë aplikimin e paraqitur nga subjekti "TV kabllor AVN" për rinovimin e licencës.

Mbështetur në vendimin nr.842, datë 24.4.2009 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor "TV kabllor AVN", KKRT vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës për subjektin "TV kabllor AVN", pasi nuk kishte depozituar deklaratën mbi vërtetësinë e të dhënave dhe deklaratën përkatëse noteriale; nuk kishte paraqitur kontratat e punës dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për personat e punësuar.

KKRT vëren se gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Konkretisht, për transmetimin e programeve pa të drejta transmetimi, KKRT, me vendimin nr.515, datë 9.10.2006, ka vendosur të reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës në masën 50% të afatit të saj. Edhe pse afati i vlefshmërisë së licencës për subjektin televiziv privat kabllor AVN ka përfunduar më datë 12.11.2007, ky subjekt ka vazhduar të transmetojë programe pa të drejta transmetimi, në kundërshtim me nenin 40/1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar. Për pirateri, subjekti është ndëshkuar me sanksionet me gjobë nr.198, datë 12.10.2009 në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe nr.255, datë 22.6.2010, në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25, 40/1 dhe 33 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr.515, datë 9.10.2006 të KKRT-së, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë", miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

#### VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.022/RTV kabllor, të subjektit radiofonik privat kabllor "TV kabllor AVN".
2. Licenca me nr.022/RTV kabllor "AVN" bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti, sipas pikës 1, të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative". Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.48, datë 28.7.2010**

**MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“DIBRA VIZION”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahimimi	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat vendor “Dibra Vizion”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 dhe nenit 22, 25 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimi nr.848, datë 24.4.2009 i KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**VËREN SE:**

KKRT, me vendimin nr.232, datë 30.3.2004, ka licencuar personin privat fizik z.Dëfrim Koçi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor në bashkinë Dibër, për një periudhë prej 5 vjetësh. Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës, subjekti privat fizik Dëfrim Koçi ka depozituar në KKRT dokumentacionin përkatës për rinovimin e licencës.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit tërësor të aplikimit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, KKRT, me vendimin nr.848, datë 24.4.2009, vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës për TV “Dibra Vizion”, si rrjedhojë e mosparaqitjes së dokumentit që vërteton pagesën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për personat e siguruar.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.12.2009, mori në shqyrtim aplikimin për rinovim licence të subjektit “TV Dibra Vizion”. Nga shqyrtimi i aplikimit rezultoi se ky subjekt nuk kishte depozituar ekstraktin e QKR-së. Për këtë arsye, KKRT vendosi që subjekti të njoftohet për të plotësuar mangësinë e konstatuar, duke i lënë në dispozicion një afat të caktuar.

Në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregulloren “Mbi rilicencimin e operatorëve radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së dhe urdhrin nr.35 të kryetarit të KKRT-së, më datë 22.2.2010, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit konstatoi se subjekti kishte paraqitur ekstraktin e QKR-së.

Nga shqyrtimi i ekstraktit të QKR-së, rezultoi se pronar i TV “Dibra Vizion” është bërë subjekti privat fizik Hajri Hoxha. Me vendimin nr.232, datë 30.3.2004, për televizionin privat vendor “Dibra Vizion”, KKRT ka licencuar personin privat fizik z.Dëfrim Koçi për një periudhë prej 5 vjetësh. Edhe aplikimi për rinovimin e licencës për TV “Dibra Vizion”, si dhe plotësimet e kërkuara sipas vendimit nr.848, datë 24.4.2009 të KKRT-së, janë paraqitur nga subjekti Dëfrim Koçi, ndërsa depozitimi i ekstraktit të QKR-së, i kërkuar nga KKRT-ja në mbledhjen e datës 22.12.2009, është paraqitur nga subjekti Hajri Hoxha.



KKRT konstaton se, nga ana e subjektit televiziv privat vendor "TV Dibra Vizion" nuk është respektuar neni 22 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, i ndryshuar, sipas të cilit "Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë...". Gjithashtu, KKRT vëren se nga "TV Dibra Vizion" nuk është respektuar neni 30 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, pasi subjekti nuk ka paraqitur asnjë arsye që të justifikojë ndryshimin e të dhënave, e konkretisht të kalimit të pronësisë nga z.Dëfrim Koçi tek subjekti privat fizik z.Hajri Hoxha. Nga ana tjetër, nga shqyrtimi tërësor i aplikimit për rinovimin e licencës, rezulton se subjekti "TV Dibra Vizion" nuk ka depozituar pranë KKRT-së bilancin financiar për vitin 2007.

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22, 25 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr.848, datë 24.4.2009 të KKRT-së, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë", miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

#### VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.066/TVL, të subjektit televiziv privat vendor "TV Dibra Vizion".
2. Licenca me nr.066/TVL bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti, sipas pikës 1, të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

#### VENDIM

**Nr.54, datë 28.7.2010**

#### **PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE "GRETA MUSIC RADIO" SUBJEKTIT: "G.M. RADIO" SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

#### VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "G.M. Radio" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për të mbuluar me sinjal qytetin e Tiranës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.55, datë 28.7.2010**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO ONE”**  
**SUBJEKTIT: “RADIO ONE” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë subjektit “Radio One” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.56, datë 28.7.2010**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO ONE”**  
**SUBJEKTIT: “MEDIA NORD” SHA**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë subjektit “Media Nord” sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për të mbuluar me sinjal rrethin e Shkodrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.57, datë 28.7.2010**

**PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI**

**PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO ENERGY”**  
**SUBJEKTIT: “NRG MULTIMEDIA” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidatave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “NRG Multimedia” sh.p.k. për radion vendore private “Radio Energy”, sipas licencës nr.051/FML, në qarqet Fier –Vlorë.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.58, datë 28.7.2010**

**PËR MOSZGJERIM ZONE LICENCIMI**  
**PËR RADION VENDORE PRIVATE “LOVE RADIO”**  
**SUBJEKTIT: “ANTENA” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidatave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos zgjerojë zonën e licencimit të operatorit radiofonik privat vendor “Love Radio”, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit për zgjerimin e zonës së licencimit rezultoi se nuk identifikohet autori i projektit teknik; nuk është depozituar deklarata noteriale; nuk janë paraqitur të dhënat mbi numrin e punonjësve dhe organigrama, si dhe nuk është depozituar garancia bankare në masën 10% të kapitalit dhe nuk është kryer pagesa për përpunimin e dokumentacionit.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
Endira Bushati

VENDIM  
Nr.59, datë 28.7.2010

**PËR MOSZGJERIM ZONE LICENCIMI  
PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO DJ 96.1”  
SUBJEKTIT: “RADIO LINK” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos zgjerojë zonën e licencimit të operatorit radiofonik privat vendor “Radio Dj 96.1”, pasi, nga shqyrtimi i dokumentacionit për zgjerimin e zonës së licencimit, rezultoi se subjekti është gjetur në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së, në frekuencat 88 MHz dhe 90.7 MHz, në qytetet Fier dhe Vlorë; nuk identifikohet autori i projektit teknik; nuk është depozituar deklarata noteriale; nuk janë paraqitur të dhënat mbi numrin e punonjësve dhe organigrama, si dhe nuk është depozituar garancia bankare në masën 10% të kapitalit dhe nuk është kryer pagesa për përpunimin e dokumentacionit.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
Endira Bushati

**VENDIM**  
**Nr.60, datë 28.7.2010**

**PËR MOSZGJERIM ZONE LICENCIMI**  
**PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO B-94”**  
**SUBJEKTIT: “DYNAMIC SOUND” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të mos zgjerojë zonën e licencimit të operatorit radiofonik privat vendor “Radio B-94”, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit për zgjerimin e zonës së licencimit rezultoi se nuk është depozituar deklarata noteriale; nuk janë pasqyruar kushtet që 15% e programeve javore të programohen për programe dhe informacione që lidhen me realitetin vendor, por që nuk kanë karakter tregtar; që një pjesë e madhe e kohës së transmetimit t’u rezervohet veprave europiane; angazhimi që koha e transmetimit të reklamave mos të kapërcejë 10% të kohës ditore të transmetimit; që 15% e kohës së transmetimit të jetë emisione të prodhuara vetë dhe që jo më pak se 30% e kohës së transmetimit të jetë emisione të prodhuara në Shqipëri, si dhe nuk është kryer pagesa për përpunimin e dokumentacionit.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.61, datë 28.7.2010**

**PËR MOSDHËNIE LICENCE**  
**PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO BLU”**  
**SUBJEKTIT: “TIRANA TV” SHA**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “Tirana TV” sh.a., pasi në dokumentacionin e paraqitur, mungonin projekti teknik dhe plani i implementimit 6610

të projektit; nuk janë paraqitur të dhënat mbi numrin e punonjësve dhe organigrama, si dhe nuk është kryer pagesa për përpunimin e dokumentacionit.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.62, datë 28.7.2010**

**PËR MOSDHËNIE LICENCE**  
**PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO APOLLON”**  
**SUBJEKTIT: “FKT” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “FKT” sh.p.k., pasi, në dokumentacionin e paraqitur, mungonte ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mungonte planimetria e pikës transmetuese; tipi i antenës transmetuese; skema për lidhjen e studios me transmetuesin; zona e mbulimit dhe afati kohor për realizimin e planit të implementimit të projektit; të dhënat mbi programet nuk ishin të plota; janë depozituar 4 CV (nga 5 CV që përcakton rregullorja).

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.63, datë 28.7.2010**

**PËR MOSDHËNIE LICENCE**  
**PËR RADION VENDORE PRIVATE “CITY STAR RADIO”**  
**SUBJEKTIT: “STAR MEDIA” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimeve nr.882, datë 28.9.2009 dhe nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “Star Media” sh.p.k., pasi në përfundim të vlerësimit me pikë, ky subjekt u rendit në vend të dytë.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.52, datë 9.8.2010**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOKA & ERGI**  
**ENERGY PESHK” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.8.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Peshk”.
  2. Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE .....	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË .....	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.9.2010  
Doli nga shtypi më 9.9.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë